



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 23 korrik 2014  
Nr.ref.:VMP689/14

## VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

**Rastin nr. KO119/14**

Parashtrues

**Xhavit Haliti dhe 29 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

## **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga 30 (tridhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Hashim Thaçi, Xhavit Haliti, Hajredin Kuçi, Enver Hoxhaj, Arsim Bajrami, Memli Krasniqi, Margarita Kadriu-Ukelli, Zenun Pajaziti, Elmi Reçica, Rafet Rama, Ganimete Musliu, Selvije Halimi, Safete Hadërgjonaj, Bekim Haxhiu, Flora Brovina, Fadil Beka, Xhevahire Izmaqu, Agim Aliu, Sala Berisha-Shala, Agim Çeku, Besim Beqaj, Raif Qela, Naim Fetahu, Blerta Deliu-Kodra, Mexhide Mjaku-Topalli, Adem Grabovci, Azem Syla, Nuredin Lushtaku, Nezir Çoçaj dhe Kadri Veseli (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës). Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), parashtruesit e kërkesës e kanë autorizuar z. Xhavit Halitin për t'i përfaqësuar ata.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin Nr. 05-V-001 të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi) për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur përkitazi me procesin e konstituimit të Kuvendit, më 17 korrik 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata i kushtetutshmërisë së vendimit të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit, me të cilin z. Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është aplikuar gjatë seancës konstitutive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik 2014, duke pretenduar se ka shkelje të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës e Kuvendit).
5. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se procedura e e konstituimit të Kuvendit nuk është zhvilluar në pajtim me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës dhe me Kreun III [Konstituimi i Legjislaturës së Kuvendit] të Rregullores së punës të Kuvendit që përcakton procedurën që duhet ndjekur për konstituimin e Kuvendit.
6. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, konkretisht të pezullojë procesin konstituv të Kuvendit deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *“Masa e Përkohshme është në interes të publikut, sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyesëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe demokracinë në Republikën e Kosovës”*.

## **Baza juridike**

7. Parashtruesit e bazojnë kërkesën në nenin 113.5 të Kushtetutës; në nenet 27, 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullat 54, 55 dhe 56.3 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

8. Më 18 korrik 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
9. Më 21 korrik 2014, në mbështetje të rregullit 33 të Rregullores së punës, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KO119/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KO119/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
10. Gjykata, po ashtu, i referohet njoftimit me shkrim nga gjyqtari Kadri Kryeziu, të 26 qershorit 2014, për përjashtimin e tij nga seancat e këshillimeve për periudhën qershor-korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendime të caktuara të ngritura ndaj tij.
11. Më 21 korrik 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës.
12. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentes së Republikës së Kosovës, Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria në detyrë), deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit). Këtij të fundit i është kërkuar të dorëzojë në Gjykatë një kopje të transkriptit nga mbledhja konstituive e mbajtur më 17 korrik 2014.
13. Më 23 korrik 2014, pas dëgjimit të gjyqtarit raportues dhe pas diskutimit lidhur me kërkesën për masë të përkohshme të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata vendosi të miratojë kërkesën për Masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

## **Përmbledhje e shkurtër e fakteve**

14. Më 7 maj 2014, Kuvendi, në seancë të jashtëzakonshme, vendosi për shpërndarjen e legjislaturës së katërt të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
15. Më 8 maj 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës dekretoi zgjedhjet e parakohshme që do të mbaheshin më 8 qershor 2014.
16. Më 8 qershor 2014 u mbajtën zgjedhjet në Republikën e Kosovës.
17. Më 27 qershor 2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) publikoi rezultatet e zgjedhjeve.

18. Më 4 korrik 2014, KQZ-ja certifikoi rezultatet e zgjedhjeve.
19. Më 7 korrik 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës vendosi që mbledhja konstitutive të mbahet më 17 korrik 2014.
20. Më 12 korrik 2014, Kryesia e Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, mbajti mbledhjen e saj me qëllim përgatitjen e rendit të ditës për mbledhjen konstitutive.
21. Më 17 korrik 2014, Kuvendi mbajti seancën konstituive, të kryesuar nga anëtarja më e vjetër e Kuvendit, znj. Flora Brovina (në tekstin e mëtejshëm: Kryesuesja) dhe e ndihmuar nga anëtarja më e re e Kuvendit, znj. Teuta Rugova. Kryesuesja ndoqi këtë procedurë:
  - a. Kryesuesja kërkoi nga përfaqësuesit e partive politike të nominonin përfaqësuesit e tyre përkatës për Komisionin ad hoc për verifikimin e kuorumit dhe mandateve të deputetëve;
  - b. Komisioni ad hoc i raportoi Kuvendit duke konfirmuar se 120 deputetë ishin të pranishëm në sallë dhe, në bazë të listës së rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve, verifikoi mandatet e Deputetëve;
  - c. Kryesuesja kërkoi nga deputetët që të votonin raportin e Komisionit ad hoc që u miratua nga 117 deputetë që votuan për dhe me asnjë votë kundër;
  - ç. Kryesuesja kërkoi nga deputetët që të betoheshin, gjë të cilën ata e bënë;
  - d. Kryesuesja, në bazë të raportit të Komisionit ad hoc, kërkoi nga përfaqësuesi i partisë politike PDK që të propozonte kandidatin për Kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nga tri partitë më të mëdha politike që të propozonin kandidatët e tyre për Nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
  - dh. Kryesuesja e vuri në votim kandidatin e partisë politike PDK, me ç'rast përfaqësuesit e partive politike LDK, VV, AAK, Nisma dhe Lista Srpska braktisën sallën; dhe
  - e. Kryesuesja e shpalli seancën të përfunduar deri në njoftimin tjetër, sepse nuk kishte kuorum, pra vetëm 47 deputetë ishin të pranishëm.
22. Pastaj, edhe pse seanca konstitutive e Kuvendit zyrtarisht ishte përfunduar nga Kryesuesja, partitë politike LDK, AAK, NISMA, VV dhe deputetët nga pakica serbe (gjithsej 83 deputetë) u kthyen në sallën e Kuvendit ku anëtarja më e re e Kuvendit, deputetja znj. Teuta Rugova, kryesoi mbledhjen me 83 deputetë të pranishëm për të votuar mocionin e paraqitur nga LDK, AAK, Nisma dhe VV duke ndërruar Kryesuesen, deputeten Flora Brovina. Mocioni u miratua me 82 vota për. Me atë rast, deputetja Milka Vuliq, anëtarja e dytë më e vjetër e Kuvendit dhe anëtare e Listës Srpska e vazhdoi kryesimin e mbledhjes që çoi deri te Vendimi Nr. 05-V-001, me të cilin Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit me 65 vota për, nga 83 deputetë të pranishëm.

### **Argumentet e paraqitura nga parashtruesit**

23. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *“Konstituimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur pas*

*zgjedhjeve të mbajtura më 8 qershor 2014, paraqet një rëndësi të madhe për Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës si dhe ndikon drejtpërdrejtë edhe në formimin e institucioneve tjera demokratike duke përfshirë edhe Qeverinë”.*

24. *Megjithatë, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se “Gjatë përgatitjes për mbledhjen konstituive të legjislaturës së V-të të Kuvendit dhe gjatë mbajtjes së kësaj mbledhje ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit. Gjatë mbledhjes, me datën 12.07.2014, nga kryesuesi i mbledhjes Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, z. Krasniqi, pati tejkalim të kompetencave të tij që dalin jashtë mandatit të përcaktuara në Kushtetutë, gjegjësisht interpretimit të tij për Grupin më i madh parlamentar gjegjësisht sipas ish-kryetarit ‘Grupi Parlamentar’ i formuar me 47 deputetë gjatë procesit të regjistrimit të deputetëve të Legjislaturës së V-të, duhet të ulet në qendër dhe si rrjedhojë ky Grup Parlamentar duhet edhe të propozojë Kryetarin e Kuvendit. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që ‘Grupi Parlamentar LDK-AAK-NISMA’ nuk janë certifikuar si Grupi më i madh parlamentar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, siç është përcaktuar në Nenin 15 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 31 / 15 qershor 2008), veprimi i Kryetarit të Kuvendit nga Legjislatura e IV, që ka autorizuar bashkimin në një Grup Parlamentar të deputetëve të LDK-së, AAK-së dhe NISMA, pa u certifikuar si Grupi më i madh parlamentar, para konstituimit të Legjislaturës së V-të të Kuvendit të Republikës së Kosovës përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 64 (1) dhe Nenit 67 si dhe Nenit 15 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 31 / 15 qershor 2008). Gjithashtu, veprimet e Kryetarit të Kuvendit nga legjislatura IV, bien ndesh edhe me praktikën e deritanishme që konfirmohen me Transkriptin nga Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit me përfaqësuesit e partive parlamentare, të mbajtur më 10.02.2011”.*
25. *Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i datës 17 korrik 2014 (Nr. 05-V00 I), për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe procedurën përgatitore e ndjekur në lidhje me procesin e konstituimit të Kuvendit, nuk është në përputhje me Dispozitat e Nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 67.2 të Kushtetutës, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. K)103/14 të parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së Nenit 84 (14) (Kompetencat e Presidentit) me nenin 95 (Zgjedhja e Qeverisë) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Nr. Ref: AGJ 671/14, 1 korrik 2014), Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar i cili ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”.*
26. *Kësisoj, në bazë të neneve të lartpërmendura, neneve 64 dhe 67 të Kushtetutës, Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO103/14, të shkeljes së pretenduar, që pretendohet të ketë ndodhur gjatë procedurës përgatitore për seancën konstituive të Kuvendit dhe gjatë seancës konstituive të mbajtur më 17 korrik 2014, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të përgjigjet në këto çështje:*

- a. *Të vlerësohet kushtetutshmëria e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 17.07.2014 (nr. 05-V-001) nëse Kryetari i Kuvendit është propozuar nga grupi më i madh parlamentar sipas nenit 67.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*
- b. *Të sqarohet cili është Grupi më i madh parlamentar, që është përcaktuar në Nenin 67 (Paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 12 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës (29 prill 2010) gjegjësisht a është Grupi Parlamentar që ka fituara në zgjedhjet për Kuvendin të datës 8 qershor 2014 apo grupimi i cili është formuar gjatë regjistrimit të deputetëve dhe si rrjedhojë: Kush ka të drejtë të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit në mbledhjen Konstituive të Kuvendit?*
- c. *Të sqarohet a ka pasur shkelje të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, sipas nenit 67.7. Cilat janë kompetencat e Kryetarit të Kuvendit nga legjislatura e mëparshme gjatë mbledhjes përgatitore të datës 12.07.2014?*
- ç. *Pas mbylljes zyrtare të mbledhjes konstituive a ka pas të drejtë që të shkarkohet Kryesuesja e Seancës dhe të vazhdohet me mbajtjen e mbledhjes pa u ftuar anëtarët si dhe duke marrë parasysh këtë dhe hapat që kanë pasuar me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarit të Kuvendit a ka pasur gjatë mbajtjes së mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës a ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit?*

### **Kërkesa për Masë të përkohshme**

27. *Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, me të cilën pezullohet procesi konstitutiv i Kuvendit deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “Masa e Përkohshme është në interes të publikut, sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe demokracinë në Republikën e Kosovës”.*
28. *Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës, që përcakton: “Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme”.*
29. *Gjithashtu, Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, që parashikon:*

*“(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*

*(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe*

[...]

*Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.*

30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa është *prima facie* e pranueshme, pasi është dorëzuar nga më shumë se 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda 8 (tetë) ditësh nga data e miratimit të vendimit nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur. Prandaj, janë plotësuar kërkesat nga neni 113, paragrafi 5, i Kushtetutës.
31. Prandaj, Gjykata, në bazë të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës, në bazë të nenit 27 të Ligjit, dhe në bazë të rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, gjen se parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur argumente të mjaftueshme bindëse për miratimin e kërkesës për Masë të përkohshme.
32. Rrjedhimisht, Gjykata, pa paragjykuar rastin në merita, miraton kërkesën për Masë të përkohshme.

## **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, në bazë të nenit 116, paragrafi 2 i Kushtetutës, në bazë të nenit 27 të Ligjit dhe në bazë të rregullit 55 (4) dhe 56 (3) të Rregullores së punës, njëzëri

## **VENDOS**

- I. TË MIRATOJË Masën e përkohshme;
- II. TË MIRATOJË Masën e përkohshme deri në publikimin e vendimit përfundimtar dhe jo më vonë se 18 shtator 2014 nga nxjerrja e këtij vendimi;
- III. TË PEZULLOJË MENJËHERË Vendimin për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 17 korrik 2014;
- IV. Kuvendi duhet të përmbahet nga çdo veprim deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës;

- V. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Robert Carolan



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani